FLETË UDHËZUESE PËR PACIENTIN

Para se të përdorni barin, lexoni me kujdes fletëpalosjen informuese dhe ndiqni udhëzimet mbi përdorimin! Nëse keni nevojë për informacion shtesë ose këshilla, kontaktoni mjekun apo farmacistin tuaj!

HERPLEX® krem

Aciclovirum

PËRBËRJA

Cfarë përmban HERPLEX krem?
Një gram krem përmban 50 mg aciklovir dhe lëndët jo vepruese të mëposhtme: propilen glikol, gliceril stearat polietilen glikol-100-stearat, ketostearil alkool, parafinë e lëngshme, parafinë e bardhë e butë, laurilsulfat natriumi, ujë i distiluar.

PAKETIMI

Tubeti përmban 5 g ose 10 g krem, në një kuti.

GRUPI FARMAKOTERAPEUTIK

Si vepron HERPLEX krem?
HERPLEX krem është një bar antiviral për përdorim lokal.

EMRI DHE ADRESA E BARTËSIT TË LEJES PËR TREGTIM TË BARIT/ PRODHUESIT

BELUPO Pharmaceuticals and Cosmetics, Incorporated
Ulica Danica 5
48000 Koprivnica, Kroaci

STATUSI I PËRSHKRIMIT DHE SHPËRNDARJA

HERPLEX krem lëshohet me recetë të mjekut, gjendet vetëm në farmaci!

INDIKACIONET TERAPEUTIKE

Kur mund të përdoret HERPLEX krem?

HERPLEX krem përdoret për trajtimin e infeksioneve të lëkurës të shkaktuara nga viruset Herpes Simplex, duke përfshirë infeksionet e lëkurës që hasen në zonën genitale (*herpes genitalis* primar dhe rekurent) dhe në buzë (*herpes labialis*), infeksionet e lëkurës në buzë, lëkurën rreth gojës dhe hundës.

KUNDRAINDIKACIONET

Kur nuk duhet të përdoret HERPLEX krem?

HERPLEX krem nuk duhet të përdoret nëse ju keni ndonjë reaksion alergjik ndaj aciklovirit ose ndaj ndonjë prej përbërësve të barit (skuqje të lëkurës, enjtje të gojës dhe gjuhës, rash, të kruara, acarime).

PËRKUJDESJE GJATË PËRDORIMIT

Cfarë duhet të kini parasysh gjatë administrimit të HERPLEX krem?

Nëse hasen reaksione mbindjeshmërie gjatë aplikimit të HERPLEX krem, duhet të ndërprisni menjëherë përdorimin dhe të kontaktoni mjekun tuaj.

HERPLEX krem nuk duhet aplikuar në membranat mukozale orale, të syrit, ose vaginale. Nëse aksidentalisht, kremi bie në kontakt me syrin, shplajini ato me ujë të bollshëm të ftohtë. Nëse hasen simptoma të irritimit të membranave mukozale, kontaktoni mjekun tuaj.

Shmangni prekjen e panevojshme të lezioneve, për të parandaluar përkeqësimin e sëmundjes ose përhapjen e infeksionit.

Viruse herpes simplex rezistente mund të shfaqen gjatë trajtimit me aciklovir, vecanërisht në pacientët e imunokompromentuar rëndë, dhe kjo duhet pasur parasysh në rast të dështimit të trajtimit.

NDËRVEPRIMET

A mund ta përdorni HERPLEX krem me barna të tjerë?

Para se të filloni të përdorni HERPLEX krem, informoni mjekun tuaj mbi cdo bar tjetër që ju po merrni aktualisht!

Nuk ka evidenca për ndërveprime me barna të tjerë pas aplikimit lokal të aciklovirit.

KUJDES I VECANTË

Cfarë duhet të dini para se të filloni të përdorni HERPLEX krem?

Shtatzania

Studime përkatëse tek gratë shtatzëna nuk janë realizuar, prandaj përdorimi gjatë shtatzanisë bazohet vetëm në gjykimin e mjekut mbi dobitë në krahasim me risqet e mundshme për fetusin.

Laktacioni

Nuk dihet nëse acikloviri ekskretohet në qumështin e gjirit të nënës pas aplikimit lokal. Sidoqoftë, duke qenë se nuk kemi përthithje sistemike të barit pas aplikimit lokal të aciklovirit, nuk pritet që të ekskretohet sasi të konsiderueshme të barit në qumështin e gjirit. Prandaj, HERPLEX krem mund të përdoret gjatë laktacionit, sipas gjykimit të mjekut.

Pacientët e imunokompromentuar rëndë

Tek këta pacientë (si pacientët me AIDS ose që kanë bërë transplant të palcës së kockës), duhet marrë në konsideratë administrimi oral i aciklovirit.

POSOLOGJIA DHE METODA E ADMINISTRIMIT

Si duhet ta përdorni HERPLEX krem?

Para dhe pas aplikimit të HERPLEX krem, sigurohuni të lani duart.

HERPLEX duhet përdorur sa më shpejt të jetë e mundur pas shfaqjes së simptomave të para (p.sh cpim, kruarje, djegie), të cilat zakonisht paraprijnë shpërthimin e blisterave (qeseve) në lëkurë.

HERPLEX duhet të aplikohet në lesion, dmth në lezionin që po zhvillohet, sa më shpejt të jetë e mundur pas fillimit të infeksionit. Fillimi i trajtimit të sëmundjeve rekurente gjatë periudhës prodromale ose kur shfaqen lezionet e para, është i një rëndësie të vecantë..

Sa shpesh duhet përdorur HERPLEX krem?

HERPLEX krem duhet administruar pesë herë në ditë, në intervale prej katër orësh, duke shmangur aplikimet gjatë natës. Trajtimi duhet vazhduar për 5 ditë. Nëse pas 5 ditësh, shërimi nuk është i plotë, atëherë trajtimi mund të vazhdohet edhe për një 5 ditësh tjetër.

MBIDOZA

Cfarë duhet të bëni, nëse keni aplikuar më shumë HERPLEX krem?

Duke marrë në konsideratë, përthithjen e kufizuar të barit nëpërmjet lëkurës, nuk ka gjasa të ndodhë një mbidozë e barit gjatë aplikimit lokal të HERPLEX krem.

EFEKTET ANËSORE

Cfarë efektesh anësore mund të ketë HERPLEX krem?

Efektet e padëshirueshme janë shumë të rralla gjatë aplikimit lokal të HERPLEX krem. Mund të hasen ndjesi të djegies ose cpimit të lëkurës në vendin e aplikimit. Eritema e lehtë ose tharja e lëkurës janë të rralla. Mund të hasen tepër rrallë raste të dermatitis të kontaktit (skuqje, enjtje, blistera).

Në rast se hasen efekte anësore, kontaktoni një mjek apo farmacist!

DATA E SKADENCËS

Është shënuar në paketim.

HERPLEX krem nuk duhet përdorur pas datës së skadencës!

RUAJTJA

HERPLEX krem duhet të ruhet në temperaturë deri 25 °C.
Të mbahet larg fëmijëve!

DATA E RISHIKIMIT TË TEKSTIT

Tetor, 2009

NUMRI DHE DATA E LEJES PËR TREGTIM TË BARIT

HERPLEX® krem (5 g tubet):	5566, 17.02.2010
HERPLEX® krem (10 g tubet):	5566, 17.02.2010